



ELSIG

NJË HAP PËRPARA
ONE STEP FORWARD

KOMPANIA E SIGURIMEVE SH.A.

INSURANCE COMPANY J.S.C.

info contact:

Tel: 038 221-112

info fax:

Fax: 038 221-115

info cell:

Mob: +377 44 220715

info e-mail:

kselig.prishtine@gmail.com

Prishtinë, Kosovë

10000

KOMPANIA E SIGURIMIT "ELSIG"sh. a. PRISHTINË

K U S H T E T

**PËR SIGURIMIN NGA RREZIKU I ZJARRIT DHE NGA RREZIQE
TË TJERA PLOTËSUESE**

Prishtinë, Korrik 2008.

Në bazë të nenit pika të Statutit të Kompanisë së sigurimeve “ ELSIG” sh. a. Bordi i drejtorëve i Kompanisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur ne Korrik. miratoi Kushtet për sigurimin nga rreziku i zjarrit dhe disa rreziqe tjera plotësuese.

KUSHTET PËR SIGURIM NGA RREZIKU I ZJARRIT DHE NGA RREZIQE TË TJERA PLOTËSUESE

Objekti i sigurimit

Neni 1

(1) Objekt i sigurimit nga rreziqet e përmendura në nenin 2. të këtyre Kushteve mund të jenë të gjitha gjërat përpos atyre që me këto Kushte janë të përjashtuara nga sigurimi,

(2) Të siguruara janë ato gjëra që janë të shënuara në polisë, e sipas këtyre dispozitave:

1. Te sigurimi i objekteve ndërtimore dhe të gjërave të tjera të patundshme konsiderohen të siguruara të gjitha pjesët e objektit ndërtimor, themelet e muret e bodrumeve, instalimet e montuara (ashensori, ngrohja qendrore me cisternë për karburante, bojlerët, impiantet për klimatizim, hidroforët, e të tjera). Me sigurimin e ndërtesës në ndërtim sigurohet edhe materiali ndërtimor në kantier, i destinuar për montim dhe objektin ndërtimor në ndërtim që sigurohet sipas këtyre Kushteve.

Vetëm çatia dhe pjesët e djegshme të objektit ndërtimor nuk mund të sigurohen veçmas.

2. Te sigurimi i gjërave të tundshme, në qoftë se në polisë nuk janë përmendur gjërat veç e veç por si grumbull, konsiderohet se janë të siguruara ato gjëra që gjenden në vendin e sigurimit e i takojnë grumbullit të gjërave të siguruar, si ato që kanë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës ashtu edhe ato që hyjnë pastaj në atë grumbull.

Janë të siguruara vetëm ato gjëra që janë pronë e të siguruarit dhe e personave që jetojnë bashkë me të në familje të përbashkët.

(3) Vetëm në qoftë se është kontraktuar në mënyrë të veçantë, është shënuar në policë dhe është pasqyruar në evidencën e veçantë mund të jenë të siguruara:

1. Gjërat e punëtorëve që kryejnë shërbimin në vendin e sigurimit, si dhe gjërat e personave të tretë të pranuar për riparim, përpunim, ruajtje, shitje, peng, me qira dhe për shërbim;
2. Digat – ndërtim masiv (prej guri, betoni, metali) i digave të mbushura me themel të padepërtushëm dhe të veshura me material të fortë (gur, beton etj.) nga ana e ujit;
3. Hekurudhat;
4. Brigjet e ndërtuara, skelet, mbrojtësit e limaneve dhe kanalet (guri, betoni, metali etj.);
5. Pendat – e mveshura ose të murosura me material të fortë (beton, gur, asfalt etj.);
6. Urat;
7. Rrethojat, muret mbrojtëse, rrugët, pistat e aeroplanëve, trotualet, oborret e shtruara me rrasa;
8. Rrjeti prej teli me shtylla – në vreshta, në kulpërishte, në plantacionet e pemëve etj;
9. Meliorimet, rregullacionet dhe pendat e veshura ose të muratuara të rrjedhave të ujrave të ndërtuara në mënyrë masive;
10. Rrjeti nëntokësor, mbitokësor dhe nënujor (të ujësjellësit, të kanalizimit, të telefonit, të gazit, rrjeti, elektrik e të ngjashme) përpos rrjetit që është pjesë përbërëse e ndërtesës, si dhe rrjetit në territorin e ndërmarrjes industriale;
11. Terrenet sportive, terrenet e fushave të lojës së fëmijëve, pishinat e hapura dhe fushë patinazhi;
12. Paratë dhe letrat me vlerë;
13. Gjërat në minierat nëntokësore;
14. Rezervat e plehut të shtallës;
15. Gjërat në ekspozita;
16. Rimorkiot, makinat vetëlëvizëse dhe traktorët e ekonomive bujqësore,

17. Vajrat dhe elementet tjera si katalizatorët kur vlera e tyre nuk është e përfshirë në vlerën e gjërave të siguruara ;
18. Antenat e radio stacioneve të TV programeve.

(4) Sipas këtyre Kushteve nuk mund të jenë objekt i sigurimit:

1. Ttrojet, oborret e pashtuara me rrasa, digat dhe pendat që nuk janë të ndërtuara në vështrim të alinesë (3) pika 2 dhe 5 të këtij neni, uji i detit në përpunim;
2. Brigjet e shtruara, skelet, mbrojtësit e limaneve dhe kanalet;
3. Të mbjellat në kërcyell, frutat në trung, plantacionet frytdhënës dhe jofrytdhënës (pemishtet, vreshtat etj.) përpos trupave të pemëve në oborrin rreth shtëpisë.
4. Automjetet motorike tokësore, rimorkiot dhe makinat vetëlëvizëse përpos në rastet nga alinea (3) pika 16) dhe kur ato përbëjnë rezervën tregtare në dyqanet, në depo doganore, ofiçina në riparim e të tjera;
5. Objektet lundruese në ujë;
6. Fluturaket ajrore;
7. Malli në transport;
8. Peshqit dhe kafshët e tjera në ujrat rrjedhëse dhe amullore;
9. Gjërat e ekspozuara në panairë;
10. Tullat qerpiçët e papjekura në mjedise të hapur hapësinore;
11. Rrugët pa shtresë të poshtme(shtresë zhavorri).

Rreziqet e siguruara

Neni 2.

(1) Me sigurim ofrohet mbrojtja siguruese nga këto rreziqe themelore:

1. zjarri ;
2. goditja e rrufesë dhe
3. eksplozimi.

(2) Në qoftë se parashihet në mënyrë të veçantë me kontratë dhe paguhet premia plotësuese, mbrojtja siguruese zgjerohet në një ose më shumë **rreziqe plotësuese:**

1. stuhia;
2. breshri;
3. goditja e mjetit motorik;
4. rënia e fluturakes ajrore;
5. vërshimi dhe rrëkeja,rrëkeja dhe uji me nivel të lartë;
6. shembja dhe rrëshqitja e tokës;
7. ulja e tokës;
8. pesha dhe ortiqet e borës;
9. derdhja e ujit nga instalimet;
10. rrjedhja e lëngut (lekazhi);
11. vetëndezja e rezervave;
12. derdhja e masës së zjarrtë të shkrirë të lëngshme;
13. përgjegjësia ndaj palës së tretë;
14. termeti.

(3) Kur ndodh rasti i siguruar në sigurim përfshihen:

1. dëmet nga shkatërrimi ose dëmtimi i gjërave të siguruara të shkaktuara me rastin e shpërthimit (rrëzimit, nxjerrjes përjashta, dhënies së ndihmës e të tjera)
2. dëmet për shkak të zhdukjes së gjërave të siguruara kur ndodh rasti i siguruar,
3. shpenzimet e bëra për spastrimin dhe rrëzimin lidhur me rastin e siguruar të gjërave të siguruara,

4. shpenzimet që i siguruari i ka bërë kur është krijuar rasti i siguruar në gjërat e siguruara për masat e ndërmarra për largimin dhe zvogëlimin e dëmit në nivelin e caktuar sipas nenit 22 të këtyre kushteve.
- (4) Siguruesi është i detyruar të paguajë kompensimin vetëm për dëmin e shkaktuar drejtpërdrejt në gjërat e siguruara, por jo edhe dëmin indirekt sikurse është dëmi si pasojë: e humbjes së qirasë, humbjes së shkaktuar nga ndalimi i punës, zvogëlimi i mundësisë së përdorimit dhe për shkak të humbjeve të tjera të ngjashme të shkaktuara nga rasti i siguruar.
- (3) Me sigurim nuk mbulohen dëmet:
1. nga reaksioni nuklear, radioacioni nuklear dhe kontaminimi radioaktiv;
 2. nga zjarri i cili shkaktohet nga termeti;
 3. e shkaktuara me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të siguarit;
 4. e shkaktuara direkt ose indirekt nga aktet (veprimet) keqdashëse;
 5. e shkaktuara me dashje ose pakujdesia e rëndë e anëtarve madhorë të familjes së të siguarit;
 6. e shkaktuara nga terorizmi, lufta e çdo lloji, invazioni, luftime tjera të armatosura pavarësisht se a është deklaruar lufta, lufta civile;
 7. e shkaktuara nga turbullirat civile, revolucionare, lëvizje seperatiste, kryengritje popullore, rebelime, revolta, puçe, grushtshteti, ekzode;
 8. nga konfiskimet apo format tjera të shtetëzimit të pronës nga autoriteti shtetëror dhe
 9. nga humbja e fitimit për shkak të vonësive, moskryerjes, humbjes së kontratës, gjobave etj.

Vëllimi i rrezikut të zjarrit dhe goditjes së rrufesë

Neni 3.

- (1) Zjarr, konsiderohet zjarri i shkaktuar jashtë vatrës së caktuar ose zjarri që e ka lënë këtë vend dhe është i aftë të shtrihet (zgjerohet) më tutje me forcën e vet .
- (2) Nuk konsiderohet se ka shpërthyer zjarri dhe siguruesi nuk është në obligim të paguajë kompensimin në qoftë se sendi i siguruar është dëmtuar ose shkatërruar:
1. Kur zjarrit ose nxehtësisë i ekspozohet për përpunim ose për qëllime të tjera (për shembull në përpunimin industrial gjatë hekurosjes, tharjes, fërgimit, pjekjes etj.) ose për shkak të rënies apo hedhjes në votër (stufë, shporet etj);
 2. kur përcëllohet ose digjet nga cigarja, mjeti për ndriçim, prushi etj;
 3. kur vlon ose nxehet tepër, zihet, tymoset etj;
- (3) Me sigurimin nga rreziku i zjarrit nuk janë përfshirë dëmet në tymtarë, të shkaktuara në lidhje me kryerjen e funksionit të tyre.
- (4) Sigurimi nga goditja e rrufesë, mbulohen dëmet që në sendet e siguruara i shkakton rrufeja me veprimin e fuqisë ose të nxehtësisë, si dhe dëmet nga goditja e objekteve të rrëzuara nga rrufeja.
- (5) Në sigurim nuk përfshihen dëmet :
1. në makinat, aparatet e siguruara elektrike, (duke përfshirë edhe aparatet për zierje, hekurosje, ngrohjen e shtretërve, radioaparatet, aparatet televizive, llampat, poçat elektrike etj.), ose në përçuesit elektrikë për shkak të veprimit të energjisë elektrike të tensionit të lartë ose të nxemjes për shkak të ngarkimit të tepërt, ndikimeve atmosferike si ngarkesa statike, induksioneve për shkak të zbrazjeve atmosferike dhe për shkak të dukurive të ngjashme, - sepse dëmet e këtilla konsiderohen funksionale. Mirëpo, kompensohet dëmi nga zjarri që do të shkaktohej nga veprimi i energjisë elektrike dhe që pas pushimit të këtij veprimi do të zhvillohej pavarësisht;

2. e shkaktuara nga bartja e energjisë elektrike me anë të përçuesve si pasojë e goditjes së rrufesë, si dhe dëmet në siguresat mbrojtëse të çfarëdo lloji, në ndërprerësit dhe në instalimet e ngjashme të shkaktuara gjatë kryerjes së funksionit normal të tyre.

Vëllimi i rrezikut të eksplozimit

Neni 4.

- (1) Eksplozimi, është shfaqja e papritur e forcës e bazuar në tendencën e avullit ose të gazrave për zgjerim - shpërthim.

Eksplozimi i enëve nën shtypje (kazanëve, gypave etj). ekziston vetëm kur muret e enës shkyhen deri në atë masë sa krijohet barazimi momental i shtypjes së brendshme me atë të jashtme.

1. Në qoftë se në brendinë e enës ka shpërthyer eksplozimi për shkak të reaksioneve kimike, dëmi që për këtë arsye shkaktohet në enë, kompensohet nga sigurimi edhe atëherë kur muret nuk janë të shqyer.

- (2) Me sigurim nuk përfshihen dëmet:

1. në gjërat e të siguruarit, të shkaktuara nga minimet që bëhen në kuadër të veprimtarisë së tij; ose në kuadrin e veprimtarisë së lejuar të personave të tretë;
2. në makinat, të shkaktuara nga eksplozimi në hapësirën për djegie të brendshme (cilindri i motorit);
3. nga eksplozimi që janë dukuri normale në procesin e prodhimit;
4. nga shpërthimet eksplozive në furrat dhe aparatet e ngjashme gjatë pastrimit të tyre;
5. nga eksplozimi me karakter biologjik;
6. e shkaktuara nga shpërthimi i murit akustik;
7. nga goditja e ujit që manifestohet si eksplozim në tunelet dhe gypat e ujit nën shtypje;
8. nga eksplozimi në enët nën shtypje nga alinea (l) pika 2. e këtij neni për shkak të amortizimit, dukurisë së vjetërsimit ose sedimentimit të tepërt të ndryshkut, zgjyrës, shtresës së limit në sendin e siguruar, por kompensohet dëmi në sendet e tjera në lidhje me eksplozimin që ka ndodhur dhe
9. si pasojë e zvogëlimit të shtypjes në enë – impluzionit.

Vëllimi i rrezikut të stuhisë

Neni 5.

(l) Stuhi konsiderohet era e shpejtë 17,2 metra në sekondë, respektivisht 62 km në orë (me forcë 8 shkallë sipas shkallës së Boforit) ose më tepër.

Do të konsiderohet se ka fryrë era me këtë shpejtësi në një vend ku gjenden gjërat e siguruar, në qoftë se era i ka thyer degët dhe trungjet ose i ka dëmtuar objektet ndërtimore të mirëmbajtura rregullisht. Në rast dyshimi, i siguruari duhet ta vërtetojë shpejtësinë e erës me raportin e shërbimit hidrometeorologjik.

- (2) Dëmet nga stuhia përfshihen në sigurim në qoftë se janë shkaktuar dëmtime të gjërave të siguruar:

1. me veprimin e drejtpërdrejtë të stuhisë;
2. me goditjen e drejtpërdrejtë nga objektet e rrëzuara ose të bartura,
3. përfshihen edhe dëmet nga bartja e borës me erë.

- (3) Sigurimi nga stuhia nuk përfshin dëmet:

1. nga depërtimi i shiut, breshrit, borës ose të reshurave të tjera nëpër dritare të hapur ose nëpër plasaritje të tjera që ekzistojnë në ndërtesë përpos në qoftë se këto plasaritje janë shkaktuar nga stuhia,

2. nga shiu dhe të reshurat e tjera në gjërat e vendosura në hapësirë të lirë (shtrega, mullarë etj), në kodrina, nën strehë dhe në ndërtesa të tjera të hapura;
3. nga bartja e borës me stuhi apo nga pesha e borës, përveç nëse pesha e borës ka qenë e paparaparë nëni 12 i këtyre kushteve;
4. në objektin ndërtimor që nuk është ndërtuar në harmoni me normat teknike të ndërtimtarisë, ose mirëmbajtja ka qenë jo e mirë;
5. në foliet prej materialit artificial në lehët e ngrohta, e që shërbejnë për mbulimin e bimëve drejtpërdrejt ose në formë të tunelit, nëse ndryshe nuk kontraktohen, përpos folieve që garancinë e prodhuesit e kanë më të vogël se një vit.

Vëllimi i rrezikut të breshrit

Neni 6.

- (1) Në sigurim përfshihen dëmet nga shkatërrimi, respektivisht nga dëmtimi i gjërave të siguruara që i shkakton breshri me goditjen e vet. Përfshihen edhe dëmet nga depërtimi i breshrit dhe i shiut nëpër plasaritjet e shkaktuara nga rënia e breshrit.
- (2) Në sigurim nuk përfshihen dëmet në xhama dhe folie të lehëve të ngrohta dhe të kopshteve të qelqit, si dhe dëmet në llaç të fasadës së mbajtur dobët ose të vjetëruar.

Nëse bëhet kontraktimi i veçantë përfshihet dëmi në xhamat dhe foliet e serrave, përveç në foliet të cilat janë në afatin e garancisë nga prodhuesi. Ky afat kohor i garancisë është më pak se një vit.

Vëllimi i rrezikut të goditjes së mjetit motorik

Neni 7.

Me sigurim përfshihen dëmet në objektin e siguruar që shkaktohet nga goditja direkte e mjetit motorik në objektin e siguruar, apo në mënyrë indirekte kur mjete motorik shkakton goditje në çfarëdo objekti dhe nga forca lëvizëse e këtij objekti godet dhe shkakton dëm në objektin e siguruar.

Vëllimi i rrezikut të rënies së fluturakes ajrore

Neni 8.

- (1) Konsiderohet se ka ndodhur rasti i rënies së fluturakes ajrore, në qoftë se nga rënia e drejtpërdrejtë e fluturakes ose e pjesëve të saj si dhe e objekteve nga fluturakja shkatërrohet ose dëmtohet objekti i siguruar.

Vëllimi i rrezikut nga vërshimi, rrëkeja dhe uji me nivel të lartë

Neni 9.

- (1) Vërshim, konsiderohet përmbytja e papritur stihike e terrenit nga ujërat e përhershme (lumenjtë, liqenet, detet etj). Për arsye se uji është derdhur nga shtrati ose e ka shpërthyer pendën ose pritën ose digën mbrojtëse, vërshimi i ujit për shkak të baticës jashtëzakonisht të lartë dhe valëve të detit dhe të liqeneve me forcë të jashtëzakonshme, si dhe për shkak të ardhjes së tepërt të ujit nga liqenet artificiale.

Vërshim konsiderohet edhe përmbytja e papritur e terrenit për shkak të formimit të shpejtë të sasisë së madhe të masës së ujit që krijohet si pasojë e shtrëngatës.

Me sigurim nga vërshimet përfshihen vetëm dëmet e shkaktuara në objektin e siguruar në kohën sa zgjat vërshimi dhe menjëherë pas tërheqjes së ujit.

(2) Rrëke konsiderohet përmbytja e papritur stihike e terrenit me masën e ujit që formohet në terrenet kodrinore për shkak të të reshurave të mëdha atmosferike dhe të derdhjes së ujërave nëpër xhade e rrugë.

(3) Me sigurim mbulohen dëmet në objektet hidrondërtimore nga ujërat e larta.

(4) Ujëra të larta, konsiderohen:

1. shfaqja e jashtëzakonshme e rritjes së jashtëzakonshme të nivelit të ujit në kohë të papritur;
2. uji nëntokësor si pasojë e ujit të lartë.

Obligimi i siguresit për dëmet nga uji i lartë dhe nga uji nëntokësor si pasojë e tij fillon me rritjen e nivelit të ujit mbi kuotat mujore të caktuara më parë të nivelit të ujit ose të rrjedhjes së matur sipas indikatorit të nivelit të vendosur në vendin me të afërt.

Për secilin muaj veç e veç është normal niveli më i lartë mujor i ujit për 20 vjetët e fundit që shënon treguesin me të afërt e duke përfshirë nivelet jashtëzakonisht të larta të ujit.

(4) Me sigurim nuk përfshihen dëmet:

1. nga ana e brendshme në gypat e ujit, në kanale e tunele, të shkaktuara nga veprimi mekanik i ujit;
2. nga këpu dhëzat për shkak të lagështisë,
3. nga shtresimi i truallit si pasojë e vërshimit dhe e rrëkesë,
4. nga ujërat nëntokësore në mihjen sipërfaqësore e nëntokësore, në korridoret nëntokësore dhe tunelet e mineraleve;
5. nga vërshimi i ujit të derdhur nga rrjeti i kanalizimit, përpos në qoftë se derdhja është bërë për shkak të vërshimit apo të rrëkesë,
6. në sendet e vendosura në shtretërit e gjallë dhe të thatë të përrenjve dhe të lumenjve, si dhe në hapësirën në mes të përrenjve, respektivisht të lumenjve dhe të pendave (rajoni i iudacionit), në qoftë se nuk parashihet në mënyrë të veçantë me kontratë;
7. në rezervat e mallrave që nuk janë të deponuara me paleta, në lartësi 20 cm ose sipas dispozitave të parapara,
8. në objektet hidrondërtimore për shkak të gërryerjes nga ana e jashtme, kurse në kanale, tunele dhe gype të ujit edhe dëmet nga shtypja e shkaktuar nga vërshimi në kuptimin e alinesë së sipërme, në qoftë se nuk parashihet ndryshe me kontratë.

Vëllimi i rreziku nga shembja dhe rrëshqitja e tokës

Neni 10.

(1) Rrëshqitje të tokës, konsiderohen lëvizjet e papritura të sipërfaqes së tokës në terrenet e pjerrëta me manifestime të qarta të thyerjeve në sipërfaqen e tokës dhe të shembjeve që shkaktohen për një periudhë të shkurtër me shfaqjen e deformimeve të mëdha dhe plasaritjeve të gjera në objektet ndërtimore.

(2) Shembje e tokës, konsiderohet shkëputja dhe rënia e materialit si dukuri gjeologjike apo

(3) Konsiderohet se ka ndodhur rasti i siguruar në qoftëse deformimet, dëmtimet ose shkatërrimet e gjërave të siguruara kanë ndodhur për shkak të levizjes së dheut, shtypjes ose goditjes së dheut.

(4) Në sigurim nuk përfshihen dëmet në gjërat e siguruara:

1. që ndodhin përpara ose në momentin e lidhjes së kontratës,
2. nëse rrëshqitja e tokës ose shembja është shkaktuar më veprimimtarinë e të siguarit;
3. me sigurim nuk përfshihen shpenzimet për sanimin e pjerrtësisë që ka rrëshqitur.

Vëllimi i rrezikut nga ulja e tokës

Neni 11.

- (l) Me ulje të dheut, kuptojmë lëvizjen e papritur vertikale të dheut – uljen si dukuri gjeologjike dhe hidrologjike.
- (1) Me sigurim përfshihen dëmet nga shkaktërimi ose dëmtimi i konstruksionit të gjërave të siguruara. Me dëmtimin e konstruksionit të gjërave të siguara kuptohen deformimet, plasaritjet, thyerja e pjesëve të veçanta vitale, e objekteve, impianteve, instalimeve e të ngjashme pa të cilat objekti, impiantët, instalimet etj. nuk mund të vihen në funksionin e parashikuar ose të shfrytëzohen në mënyrë të sigurt.

(3) Me sigurim nuk përfshihen dëmet në gjërat e siguruara të cilat nuk janë dëmtuar në kuptimin e paragrafit (l) dhe (2) të këtij neni:

1. ulje për shkak të gabimeve në llogaritjet statike,
2. ndryshimi i pamjes estetike të sendit të siguar,
3. centrimi, kontrollimi dhe vënia në punë e makinave dhe pajimeve të cilat nuk ka ndodhur dëmtimi i pjesëve vitale,
4. inspektimi dhe vënia në punë e të gjitha llojeve të instalimeve,
5. thyerja e xhamave të të gjitha llojeve ,
6. plasaritjet në objektet e dheut të cilat nuk e rrezikojnë stabilitetin ose funksionalitetin e objektit,
7. plasaritjet në të gjitha pjesët e objekteve ndërtimore të cilat nuk ndikojnë në stabilitetin e asaj pjese ose tërë objektit,
8. të gjitha llojet e plasaritjeve të suvatimit,
9. plasaritjet qeramike dhe në shtresimet e pllakave të tjera,
10. punët moliere – ngjyrosje dhe punimet prej arti në dhoma në objektet ndërtimore,

(4) Me sigurim nuk përfshihen dëmet indirekte, si pasojë e uljes së tokës.:

1. humbja e prodhimit,
2. humbja për shkak të ndërprerjes së punës,
3. humbja nga kontratat ose përgjegjësia,
4. shpenzimet rreth shpëtimit dhe pastrimit,
5. shpenzimet për sanimin e truallit.

Vëllimi i rrezikut pesha dhe ortiqet e borës

Neni 12.

- (1) Konsiderohet bora e cila ka rënë me një rast dhe ka mbërri peshën 150 kg. Për një metër katror (1 m²). Me këtë rast i siguruari duhet të dëshmoj peshën e borës nga Enti hidrometeorologjik.
- (2) Ortek i borës, konsiderohet masa e borës në lëvizje që shpëputet nga shpatet e maleve.
- (3)** Me sigurim përfshihen edhe dëmet e shkaktuara nga veprimi i shtypjes së ajrit prej ortekut të borës.
- (4)** Me sigurim nuk përfshihen dëmet:

Dëmet e shkaktuara nga depertimi i borës nëpër plasaritje apo vrima të hapura të ndërtesës.

Vëllimi i rrezikut të derdhjes së ujit nga instalimet

Neni 13.

(2) Derdhje e ujit, konsiderohet, derdhja e papritur e ujit nga gypat e ujësjellësit dhe të kanalizimit, si dhe nga instalimet për ngrohje me ujë të ngrohtë dhe avull. Po ashtu konsiderohet derdhje e papritur e ujit e shkaktuar nga instalimet dhe aparatet e tjera që janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit në objektin që për shkak të dëmtimit ose mbylljes (thyerjes, dëmtimit ose prishjes së impianteve) të këtyre instalimeve dhe aparateve.

1. Këto instalime i përkasin objektit të siguruar derisa nuk janë lidhur në rrjetin e jashtëm (p.sh. hidrofori, nënstacioni për ujë të ngrohtë etj).

(2) Shpërthimi i papritur i avullit nga instalimet dhe impiantet për ujë të ngrohtë dhe nxemje.

1. Me sigurim përfshihen dëmet në gjërat e siguruara që shkaktohen në kuptimin e paragrafit (l) të këtij neni edhe pse rreziku i siguruar është shkaktuar nga lokalet e tjera të ndërtesës në të cilën gjenden gjërat e siguruara.

(3) Me sigurim nuk përfshihen dëmet:

1. nga derdhja e ujit prej rubinetave të hapur si dhe nga gypat e kanalizimit, në qoftë se dëmi është shkaktuar nga zënia e gypave në lokalet e të siguruarit;
2. nga thyerja ose pëlcitja prej ngricës, të shkaktuara në vetë gypat, instalimet dhe kazanat e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
3. nga vjetërsia, korozioni, montimi në lokalet e siguruara që ai i vetëkontrollon,
4. nga këpurdhëzat e shkaktuara nga lagështia,
5. nga humbja e ujit dhe fitimi i humbur,
6. dëmet në rezervat hidroskopike të cilat nuk janë të deponuara në paleta, në largësi më së paku 20 cm ose sipas rregullave të përcaktuara;
7. nga derdhja e ujit prej ullukëve dhe gypave të ullukëve në lokalet e të siguruarit,
8. nga derdhja e ujit nga instalimet e jashtme (rrugore) etj,
9. shembja e tokës si pasojë e ujit nga gypat e ujësjellësit dhe kanalizimit,
10. nga ngrirja në instalimet dhe impiantet të cilat janë nën kontrollin e të siguruarit.

Vëllimi i rrezikut nga rrjedhja (lekazhi)

Neni 14.

(1) Rrjedhje (lekazh), konsiderohet rrjedhja e lëngjeve, respektivisht e gazrave nga enët e palëvizshme – cisternat, tubacioneve etj. në qoftë se lëngu rrjedh nga pëlcitja e papritur e enës ose nga prishja e papritur e impianteve të instaluar për lëshimin dhe zbrazjen e lëngjeve.

(2) Nuk kompensohet dëmi në qoftë se lëngu i siguruar rrjedh për shkak të plasjes së enëve ose prishjes së stabilimenteve për shkak të vjetërsisë, mosmirëmbajtjes së enës ose të impiantit për shkak të mbylljes së keqe ose kapakut të keq.

Me sigurim mbulohen vetëm dëmet në lëngun e siguruar respektivisht gazin, nëse nuk është kontraktuar ndryshe.

Nëse kontraktohet veçmas, përfshihen dëmet nga rrjedhja e lëngut në sendin e siguruar. Sigurimi mund të kontraktohet vetëm në “rrezik të parë”.

Vëllimi i rrezikut të vetëndejes së rezervave

Neni 15.

- (1) Vetëndezja është proces kalimtar fiziko-kimik dhe biologjik i materieve të cilat shndërrohen prej gjendjes së fortë në gjendje hiri ose pluhuri, pa ndikimin e burimeve të jashtme apo temperaturës së lartë,
- (2) Materiet që favorizojnë vetëndezjen janë: materiet me origjinë bimore (sana, drithërat, troseti, thëngjilli, yndyra dhe vaji me origjinë bimore, komponimet e sulfurit me metalet, komponimet metalo-organike, natriumi hidrosulfid, karbit kalciumi etj.
Materiet prej fijeve të leshit posedojnë aftësinë e vetëndezjes vetëm kur lagen me yndyrat bimore dhe shtazore: vaj ulliri, pambuku, firnajt, vajpeshku etj.
- (3) Rreziku i vetëndezjes së rezervave përfshihet me sigurim, nëse rezervat janë të deponuara sipas normave teknike ligjore.

Vëllimi i rrezikut nga derdhja e masës së shkrirë të lëngshme

Neni 16.

- (1) Nga rreziku i derdhjes së masës së zjarrtë të shkrirë të lëngshme kompensohet dëmi që shkaktohet në sendet e siguruar për shkak të derdhjes së papritur të masës së zjarrtë të shkrirë të lëngshme jashtë vendit të caktuar për lëshim ose përçim dhe në qoftë se nuk ka shpërthyer zjarri. Dëmi që bëhet me këtë rast në stabilimente për shkrirje dhe përçim kompensohet vetëm në qoftë se është shkaktuar nga veprimi i masës së shkrirë nga jashtë.
- (2) Me sigurimin kompensohet edhe dëmi në masën e shkrirë.

Pergjegjësia ndaj palës së tretë

Neni 17.

- (1) Me sigurim nga rreziku i siguruar plotësues pergjegjësia ndaj palës së tretë është e mbuluar pergjegjësia ligjore e të siguruarit për dëmin që mund t'i shkaktohet palës së tretë si: vdekja, lëndim trupor apo lëndim të shëndetit, gjegjësisht dëmtim apo shkatërrim të gjërave të palës së tretë.
- (2) Me këtë lloj sigurimi mbulohet përgjegjësia e të siguruarit për dëmin që mund të shkaktohet nga veprimtaria profesionale, nga posedimi i gjërave të rrezikshme, nga marrëdhënia juridike, apo nga burimi i rrezikshmërisë i cili është i cekur në polisën e sigurimit.
- (3) Me sigurim nuk janë të përfshira dëmet e shkaktuara:
 1. përgjegjësia e të siguruarit për dëmin e shkaktuar qëllimisht;
 2. në lidhje me shfrytëzimin e materieve radioaktive;
 3. nga përdorimi i mjeteve motorike;
 4. në rrethin familjar të të siguruarit;
 5. nga produktet me të meta;
 6. nga mosrespektimi i normave dhe rregullave teknike në kuadër të veprimtarisë profesionale;
 7. ndotja e ajrit;
 8. si pasojë e sëmundjeve profesionale të punëtorëve të të siguruarit.
- (4) Me sigurim nuk janë të mbuluara dëmet që ndodhin në gjërat:
 1. ndikimit afatgjatë të vazhdueshëm të temperaturës, gazeve, avullit, lagështisë ose të reshurave (tymit, pluhurit, blozës etj.), si edhe për shkak të mykut, tronditjes etj. që ka për pasojë shkaktimin gradual të dëmit.
 2. nga ulja dhe rrëshqitja e tokës;
 3. nga vërshimet prej ujërave mbi dhe nenëtokësore.

Termeti

Neni 18

1. Rreziku plotësues termeti do të aplikohet në të gjitha llojet e sigurimit të pasurisë, kur paraprakisht është aplikuar sigurimi nga zjarri.
2. Do të konsiderohet se ka ndodhur termet, atëherë kur nga dridhja e tokës shkaktohen dëmtime ose shkatërrime në objektet e siguruara ndërtimore apo gjërat e tjera të siguruara.
3. Drridhjet nga termeti do të konsiderohen ato dridhje të tokës të shkaktuara nga intensiteti i termetit mbi 5 shkallë të Merkill -it ; Cancan-it dhe Sieberger-it në gjërat e siguruara.
4. Objektet ndërtimore të cilat sigurohen nga termeti duhet të jenë të ndertuara në përputhje me zonën seizmike.
5. Shuma e siguruar nga termeti duhet të jetë 80% e shumës së siguruar nga zjarri.
6. Konsiderohen të siguruara edhe gjërat e dëmtuara apo të shkatërruara nga zjarri apo eksplozimi që janë si pasojë e termetit të ndodhur.
7. Termeti i shkaktuar duhet të jetë i regjistruar në mënyrë sizmike – në entin sizmik.
8. Një rast i krijuar do të konsiderohet dridhja e parë e çfaqur dhe çdo dridhje tjetër e cila ndodh mbrenda intervalit kohor prej 72 orëve nga paraqitja e dridhjes së parë.

Janë të përfshira dëmet në gjërat e siguruara, të dëmtuara apo të shkaktëruara nga derdhja e lëngjeve,gazrave nga instalimet gjegjëse të cilat janë të dëmtuara si pasojë e ndodhjes së termetit.

9. Me sigurim nuk janë të mbuluara dëmet në gjërat e siguruara të cilat nuk është shkaktuar dëmtim në kuptim të pikës (8) dhe (9) të këtij neni:

1. ndërrimi i pamjes estetike të gjërave të siguruara;
2. centrimi,shqyrtimi dhe lëshuarja në punë makinave dhe aparateve të cilat nuk janë dëmtuar pjesët vitale;
3. shqyrtimi dhe lëshuarja në punë e të gjitha llojeve të instalimeve;
4. thyerja e të gjitha llojeve të qelqeve;
5. plasaritjet në të gjitha pjesët e objektit ndërtimor prej dheu, të cilat nuk e rrezikojnë stabilitetin dhe funksionalitetin e objektit;
6. plasaritjet e të gjitha llojeve në pllakat e qeramikës,në të gjitha llojet e llaçeve ,punët moliere etj.

(11) Me sigurim nuk përfshihen dëmet indirekte si pasojë e termetit që janë:

1. e humbura në prodhim;
2. e humbura për shkak të ndërprerjes së punës;
3. e humbura në përgjegjësitë e kontraktuara;
4. e bëra për harxhimet e shkaktuara për shpëtim dhe spastrim;
5. në zvogëlimin e vlerës estetike.

Vlera e gjërave të siguruara

Neni 19.

Vlera e gjërave të siguruara, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe, është:

1. për objektet ndërtimore - çmimi i ndërtimit të objektit të ri sipas çmimeve në vendndodhjen, ku gjenden objektet e siguruara,
2. për rezervat e mallit, materialit dhe të lëndës së parë çmimi i blerjes, ndërsa nëse çmimi i tregut është më i vogël se çmimi i blerjes, atëherë çmimi i tregut rritet për shpenzimet varëse;
3. për rezervat e produkteve të gatshme dhe të prodhimit të pakryer të prodhuesi – çmimi i prodhimit, e në qoftë se çmimi i tregut është më i ulët se çmimi i prodhimit – çmimi i tregut;
4. për makina, stabilimente dhe instalime, mjete transporti dhe mjete ndërlidhëse inventar dhe mjete të amvisnisë – çmimi i blerjes së sendeve, i zvogëluar për shumën e i zvogëluar për shumën e përdorimit të vlerësuar (ekonomik ose teknik); amortizimit të vlerësuar (teknik dhe ekonomik);
5. për pyje – shpenzimet e ngritjes, respektivisht vlera e masës së drurit, që duhet të caktohet për secilin rast veç e veç;
6. për gjërat nga metalet e çmueshme, metalet e çmueshme të papërpunuara, gurët e çmueshëm dhe gjerdanët prej margaritarëve, sendet e rralla të çmueshme, veprat artistike, planet, datotekat, vizatimet, modelet, kallëpet, maketat, dokumentet, dorëshkrimet, objektet e koleksioneve dhe librat afaristë – shuma caktohet me marrëveshje në mes të siguruesit dhe kontraktuesit të sigurimit.
7. për para, letra me vlerë, lëndë arkivor, muze e sende të ekspozuara – shuma caktohet me marrëveshje në mes të siguruesit dhe kontraktuesit të sigurimit.

Vendi i sigurimit

Neni 20.

- (1) Sigurimi vlen për kohën derisa gjërat e siguruara gjenden në vendin e shënuar në polisë,
- (2) Sigurimi vlen edhe atëherë kur të gjitha gjërat e siguruara barten nga vendi i shënuar në polisë në çdo vend në kuadrin e selisë së të siguarit, respektivisht të vendbanimit në territorin e Kosovës.
- (3) Gjërat e ekonomive bujqësore, të siguruara grumbull me një polisë (sigurimi paushall) janë të siguruara edhe derisa të gjenden në pronën bujqësore, në tregje në vendin e përpunimit të riparimit dhe të shërbimit.
Këto sende konsiderohen të siguruara edhe gjatë transportit dhe kthimit prapa, përpos kur transportohen me mjete publike të komunikacionit.
- (4) Mjetet e organizatave punuese janë të siguruara edhe në vendin e përpunimit, riparimit si dhe të personat të cilëve u janë dhënë për shërbim ose me qira.
- (5) Në qoftë se gjërat e siguruara, sipas natyrës së përdorimit, transferohen prej një vendi në tjetrin, kjo duhet të shënohet në polisë. Në këtë rast, në qoftë se nuk mund të shënohen saktësisht vendet e veçanta të sigurimit, vendi i sigurimit është i kufizuar në territorin e Kosovës.
- (6) Sigurimi nuk vlen për kohën kur gjërat e siguruara gjenden në ekspozitë, në panair, në qoftë se nuk kontraktohet veçant.
- (7) Te sigurimi i kontraktuar në "rrezik të parë" në polisën e sigurimit theksohet saktësisht vendi i sigurimit-lokacioni për të gjitha gjërat e siguruara.

Përcaktimi i kompensimit nga sigurimi

Neni 21.

- (1) Masa e kompensimit të sigurimit përcaktohet:

1. në rast të shkatërrimit ose zhdukjes së gjërave sipas vlerës së tyre të siguar neni (19) në kohën kur ndodh rasti i siguar, zvogëluar me vlerën e asaj që mbetet;
2. në rast dëmtimi – në masën e shpenzimeve të riparimit sipas çmimeve të materialit dhe të punës në kohën kur ndodh rasti i siguar, zvogëluar me shumën e amorizimit të vlerësuar dhe vlerës që ka mbetur, në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe.

Shpenzimet më të mëdha të riparimit, për shkak se gjatë riparimit të gjërave të dëmtuara janë bërë ndryshime, përmirësime ose përsosje, bien në ngarkesë të siguruarit.

- (2) Për rrugët e shtruara dhe rrugët pyjore pranohet kompensimi i dëmit në shtresën e sipërme vetëm në rast se njëkohësisht në të njëjtin vend është dëmtuar edhe shtresa e poshtme. Për dëmet në shtresën e poshtme kompensohet më së shumti shuma e shpenzimeve për ndërtimin e pjesës së ndërtuar të shtresës sipas projektit.
- (3) Nëse gjërat janë të siguruara në "rrezik të parë" nga rreziku i siguruar për dëmin që do të ndodhë do të ketë mbulesë, dëmi do të paguhet në masën e dëmit të ndodhur, por jo më shumë se deri në vlerën e sigurimit në "rrezik të parë". Rasti i proporcionit në këtë rast nuk do të aplikohet.
- (4) Nëse gjatë afatit të sigurimit, ndodhin dëme, një apo disa raste të siguruara dhe shuma e sigurimit në "rrezik të parë" zbrazet, atëherë sigurimi përfundon së ekzistuari.

Kompensimi i shpenzimeve

Neni 22.

- (1) Në emër të shpenzimeve të bëra për pastrim dhe rrënim në lidhje me rastin e siguruar që ndodh në gjërat e siguruara, siguruasi kompensohet shpenzimet e domosdoshme për pastrim dhe rrënim. Por, në qoftë se nuk kontraktohet ndryshe, më së shumti deri në 2 % (për qind) e shumës së sigurimit, respektivisht vlerës reale të sendit të dëmtuar në sigurime a vlerës së kontraktuar reale të sendit të dëmtuar në çfarëdo kohe, kurse nga vlera e re e sigurimit për vlerën e re të sendit të dëmtuar. Në shpenzime të pastrimit hyjnë shpenzimet e domosdoshme për pastrim dhe pastrimin e vendit në të cilin është shkaktuar dëmi si dhe shpenzimet për bartjen e pjesëve të djegura, të mbeturinave dhe të lymit deri te vendi më i afërm, i lejueshëm për shkarkime të këtilla.

Në shpenzimet e rrënit hyjnë shpenzimet e domosdoshme që i bën kontraktuesi i sigurimit pasi ndodhet rasti i siguruar për rrënimin e pjesëve të tjera të mbetura të dëmtuara të papërdorshme dhe për bartjen e tyre deri te vendi më i afërt i lejuar për shkarkime të këtilla.

- (2) Në rastin e nënsigurimit, shpenzimet për pastrim, rrënim, si dhe shpenzimet për evitimin dhe zvogëlimin e dëmit kompensohen në të njëjtin përpjesëtim si edhe kompensimi nga neni 22, përpos në rastet kur këto shpenzime bëhen me urdhrin e siguruasit,
- (3) Siguruasi nuk është i obliguar t'i kompensojë shpenzimet për mënjanimin e shkaqeve të dëmeve, si dhe të shpenzimeve të intervenimit të shoqërisë së zjarrfikësve ose të organizatave të tjera që, sipas veprimtarisë, e kanë për detyrë të japin ndihmë pa pagesë kur ndodh rasti i siguruar.
- (4) Kompensimi i gjithmbarshëm në emër të shpenzimeve nga paragrafi pararendës dhe në emër të kompensimit nga sigurimi nuk mund ta kalojë shumën e sigurimit, respektivisht vlerën reale të gjërave të siguruara.

Vlera e kushteve të përgjithshme për sigurimin e pasurisë

Neni 23.

Në qoftë se nuk janë në kundërshtim me këto Kushte, në sigurimet e lidhura sipas këtyre kushteve, zbatohen edhe Kushtet e përgjithshme për sigurimin e pasurisë.

Neni 24.

8. Rreziku plotësues termeti do të aplikohet në të gjitha llojet e sigurimit të pasurisë, kur paraprakisht është aplikuar sigurimi nga zjarri.
9. Do të konsiderohet se ka ndodhur termeti, atëherë kur nga dridhja e tokës shkaktohen dëmtime ose shkatërrime në objektet e siguruara ndërtimore apo gjërat e tjera të siguruara.
10. Drridhjet nga termeti do të konsiderohen ato dridhje të tokës të shkaktuara nga intensiteti i termetit mbi 5 shkallë të Merkall -it ; Cancan-it dhe Sieberger-it në gjërat e siguruara.

11. Objektet ndertimore të cilat sigurohen nga termeti duhet të jenë të ndertuara në perputhje me zonën seizmike.
12. Shuma e siguruar nga termeti duhet të jetë 80% e shumës së siguruar nga zjarri.
13. Konsiderohen të siguruara edhe gjërat e dëmtuara apo të shkatërruara nga zjarri apo eksplodimi që janë si pasojë e termetit të ndodhur.
14. Termeti i shkaktuar duhet të jetë i regjistruar në mënyrë sizmike – në entin sizmik.
8. Një rast i krijuar do të konsiderohet dridhja e parë e çfaqur dhe çdo dridhje tjetër e cila ndodh mbrenda intervalit kohor prej 72 orëve nga paraqitja e dridhjes së parë.

Janë të përfshira dëmet në gjërat e siguruara, të dëmtuara apo të shkatërruara nga derdhja e lëngjeve, gazrave nga instalimet gjegjëse të cilat janë të dëmtuara si pasojë e ndodhjes së termetit.

9. Me sigurim nuk janë të mbuluara dëmet në gjërat e siguruara të cilat nuk është shkaktuar dëmtim në kuptim të pikës (8) dhe (9) të këtij neni:

7. ndërrimi i pamjes estetike të gjërave të siguruara;
8. centrimi, shqyrtimi dhe lëshuarja në punë makinave dhe aparateve të cilat nuk janë dëmtuar pjesët vitale;
9. shqyrtimi dhe lëshuarja në punë e të gjitha llojeve të instalimeve;
10. thyerja e të gjitha llojeve të qelqeve;
11. plasaritjet në të gjitha pjesët e objektit ndertimor prej dheu, të cilat nuk e rrezikojnë stabilitetin dhe funksionalitetin e objektit;
12. plasaritjet e të gjitha llojeve në pllakat e qeramikes, në të gjitha llojet e llaçeve, punët moliere etj.

(11) Me sigurim nuk përfshihen dëmet indirekte si pasojë e termetit që janë:

6. e humbura në prodhim;
7. e humbura për shkak të ndërprerjes së punës;
8. e humbura në pergjegjësitë e kontraktuara;
9. e bëra për harxhimet e shkaktuara për shpëtim dhe spastrim;
10. në zvogëlimin e vlerës estetike.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHTJEVE

Neni 25.

Kur mosmarrëveshjet midis të siguarit dhe siguruesit nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

Këto Kushte hyjnë në fuqi ditën e miratimit dhe do të zbatohen prej **Korrik 2008.**